

Shtator 2011 – Versioni 1.0



ZBATIMI I VLERAVE, POLITIKAVE DHE STANDARTEVE CILESORE

PERDORUESIT KRYESORE

I detyrueshem per:

- Te gjitha shoqatat nacionale dhe shoqatat mbeshtetese (PAS) te SOS Fshatrat e Femijeve Nderkombetar
- Gjithe anetaret e bordit dhe punonjesit e SOS Fshatrat e Femijeve
- Te gjitha zyrat e sekretariatit te pergjithshem te SOS Fshatrat e Femijeve
- Te gjitha personat qe punojne per SOS Fshatrat e Femijeve Shqiperi

POLITIKAT BASHKANGJITISE

Politika baze: Kush Jemi Ne – Deklarata e Misionit te SOS Fshatrave te Femijeve

DOKUMENTAT BASHKANGJITISE, SISTEMET, MJETET

Politikat baze dhe standartet e cilesise Politika e mbrojtjes se femijes
Manuali Burimeve Njerezore

Dokumenta mbeshtetes te politikës Udhezimet Anti-Korrupsion dhe Anti-Mashtrim
Procedurat raportuese dhe informuese te Mbrojtjes se Femijes

PERGJEGJESIA PER PERMBAJTJEN

Funksoni: Burimet Njerezore

PROCESI

Aprovuar nga: Sekretariati Pergjithshem, Shtator 2011
Ky dokument esthe zhvilluar nga Departamenti Burimeve Njerezore dhe Zhvillimit Organizates me inpute nga Shoqatat Nacionale, Stafi Menaxherial (Senior), konsulente te jashtem dhe Sekretariati Pergjithshem.

Gjuha origjinale: Anglisht
Adresa ne intranet: Intranet.soskd.org/HROD

PERMBAJTJA

HYRJE	3
1. SIGURIMI I RESPEKTIT DHE SJELLJES SE PERGJEGJESHME	4
2. SJELLJE PROFESIONALE NE LIDHJE ME FEMIJET	4
Nxitja e mireqenies dhe zhvillimit te femijes	4
Mbrojtja e femijes – ruajtja e femijes nga demtimet	4
3. SJELLJE PROFESIONALE NE LIDHJE ME ASPEKTET E TJERA TE PUNES	5
Perdorimi me pergjegjesi i pushtetit dhe pozicionit	5
Perdorimi i pergjegjshem i burimeve	6
Perdorimi i pergjegjshem i informacionit	6
4. PASOJAT E THYERJES SE KODIT TE SJELLJES	7
5. FIRMA DHE ANGAZHIMI	8

VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT

Fshatrat e Fëmijëve SOS veprojnë për fëmijët¹, si një organizatë jo-qeveritare, social-zhvilluese e pavarur. Ne respektojmë besimin fetar dhe kulturat e ndryshme, dhe punojmë në vendet dhe komunitetet ku misioni ynë mund të kontribuojë për zhvillimin e tyre. Ne punojmë në frymën e Vizionit, Misionit dhe Vlerave tona, sic janë pershkruar në udhëzuesin “Kush Jemi Ne”, të standardeve tona të cilësisë, përfshi Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve, dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve të cilat ne i promovojmë në të gjithë botën.

Vizioni ynë: Çdo fëmijë i përket një familjeje dhe të rritet me dashuri, respekt dhe siguri.

Misioni ynë: Ne ndërtojmë familje për fëmijët në nevojë, ne i ndihmojmë ato ti japin formë të ardhmes së tyre dhe ne përfshihemi dhe jemi njëloj të përgjegjës për zhvillimin e komuniteteve të tyre.

Vlerat tona:

KURAJO	Ne ndermarrim veprime
ANGAZHIMI	Ne i mbajmë premtimet
BESIMI	Ne besojmë tek njëri tjetri
PËRGJEGJSHMËRIA	Ne jemi partner i besueshëm

Këto janë besimet dhe qëndrimet kryesore mbi të cilët është ndërtuar organizata jonë, janë gurët e themelit të suksesit tonë. Këto vlera themelore shërbejnë si udhërrëfyese për veprimet, vendimet dhe marrëdhëniet tona ndërsa ne punojmë drejt përbushjes së misionit tonë, si dhe ofrimin të sigurisë për fëmijët që janë nën përkujdesjen tonë. Fshatrat e Fëmijëve SOS ndërtohen mbi këto vlera thelbësore për të ruajtur reputacionin e tyre si një organizatë përkujdesëse me cilësi, integritet dhe respekt për fëmijët. Fshatrat e Fëmijëve SOS gjithashtu pranojnë ekzistencën e kodeve dhe udhëzuesve të tjerë jashtë organizatës SOS që mbështesin punën tonë në përputhje me të drejtat e fëmijëve dhe parimet humanitare të cilat janë përdorur për përmirësimin e këtij kodi.

SOS Fshatrat e Femijeve e ka zhvilluar kete KOD SJELLJE per te mbeshtetur dhe nxitur standartet e larta te etikes dhe sjelljes profesionale midis punojesve dhe personave qe I bashkangjiten kesaj organizate – pa shkelur te drejtat qe aplikohen ne vendet ku ne punojme. Objektivi i Kodit te Sjelljes nuk eshte te ndeshkoje apo sanksionojë, por te rrise ndergjegjen dhe sherbeje si udhezues tek punonjesit. Per me teper ky document ka per qellim te mbroje punonjesit dhe personat e tjetër nga akuzat false per sjellje te papershtateshme ndaj femijeve.

Ky Kod i Sjelljes zbatohet për të gjithë të punësuarit, të kontraktuarit apo ata që kanë lidhje të një forme tjetër me Fshatrat e Fëmijëve SOS dhe në të gjithë lokacionet. Ai plotëson detyrimet e pergjitheshme te punonjesve te percaktuara tek libri punonjesit.

¹ Sipas Konventes se Kombeve te Bashkuara mbi te drejtat e femijeve, “femije” nenkupton ata qe janë nën 18 vjeç.

1. SIGURIMI I NJË SJELLJE TË RESPEKTUESHME DHE TË PËRGJEGJSHME

1.1 Unë jam i vetëdijshëm se si punonjës(e)/partner(e) e Fshatrave të Fëmijëve SOS përfaqësoj vazhdimisht Fshatrat e Fëmijëve SOS në punën dhe jetën time. Unë e pranoj se qëndrimi dhe sjellja ime kanë një ndikim të rëndësishëm tek fëmijët dhe punonjësit e programeve të SOS-it, si dhe mbi reputacionin e organizatës sonë. Prandaj unë do të jem i përgjegjshëm për sjelljen time si brenda ashtu dhe jashtë Fshatit të Fëmijëve SOS. Në veçanti, unë do t'u përmbahem ligjeve të vendit ku jetoj dhe punoj dhe do të veproj sipas vlerave themelore të organizatës të paraqitura më lart në vija të trasha.

1.2 Në bashkëveprimet e mia me të gjithë fëmijët, të rinjtë, punonjësit dhe partnerët e Fshatrave të Fëmijëve SOS, unë do t'i përkushtohem sjelljes jo-të dhunshme dhe jo-provokuese qoftë gjatë veprimeve ashtu edhe gjatë të folurës dhe gjesteve të mia. Unë do të respektoj të drejtat themelore të të gjithëve, pavarësisht gjinisë, paaftësisë fizike, përkatësisë etnike, fetare, shoqërore, gjuhës, HIV-it/SIDA-s apo statusit tjetër shëndetësor dhe aspekteve të tjera të identitetit. Unë do të veproj në mënyrë të drejtë, me ndershmëri dhe me takt dhe do t'i trajtoj njerëzit me dinjitet dhe respekt. Unë do të respektoj legjislacionin kombëtar, kulturën, traditat, zakonet dhe praktikatat vendore që janë në përputhje me konventat e OKB-së. Prandaj, unë nuk do të marr pjesë në asnjë formë diskriminimi, ngacmimi apo abuzimi (fizik, seksual apo verbal), kanosje apo shfrytëzim, ose çdo formë tjetër që shkel të drejtat e të tjerëve.

1.3 Nëse pozicioni im është ai i drejtuesit, unë e kuptoj se kam përgjegjësi shtesë në skicimin e modelit të sjelljes së mirë të promovuar përmes këtij kodi, për të krijuar një mjedis në të cilin promovohet sjellja e mirë, për të siguruar që gjithësecili të jetë i vetëdijshëm për kodin dhe të mbështetet për ta vënë atë në praktikë, për të mbarëvajtur sjelljet e pahijshme dhe trajtuar shkeljet e aktuale apo të mundshme të kodit.

2. SJELLJA PROFESIONALE NË LIDHJE ME FËMIJËT

Promovimi i mirëqënies dhe zhvillimit të fëmijëve

2.1 Unë jam i shqetësuar për gjendjen e fëmijëve në përgjithësi dhe absolutisht do të promovoj mirëqënien e tyre si dhe do kontribuoj në zhvillimin e secilit fëmijë në arritjen e potencialit të tij/saj të plotë.

2.2 Unë do të kontribuoj në krijimin e një atmosfere plot dashuri dhe përkujdesje për fëmijët. Unë do të kujdesem me respekt, drejtësi dhe mirëkuptim për fëmijët dhe do t'u përçoj atyre dobinë e drejtimit moral, vetë-disiplinës dhe udhëzimit të duhur.

2.3 Unë jam i vetëdijshëm që shërbej si shembull për t'u ndjekur nga fëmijët dhe të rinjtë dhe për këtë arsye zotohem të sillem në mënyrë të respektueshme dhe të përgjegjshme gjatë gjithë kohës. Unë i pranoj mundësitë e barabarta dhe do t'i trajtoj të gjithë fëmijët në mënyrë të barabartë, edhe nëpërmjet promovimit të praktikës së barazisë gjinore.

Mbrojtja e fëmijëve - ruajtja e fëmijëve nga lëndimi

2.4 Unë Unë s'do të zhgënjej asnjëherë besimin e dhënë nga Fshatrat e Fëmijëve SOS për të mbrojtur fëmijët dhe për t'u shërbyer interesave të tyre më të mira.

2.5 Unë do të sillem gjithmonë në mënyrë të tillë që sjellja ime të mbroj fëmijët dhe të rinjtë nga çdo formë diskriminimi, abuzimi, keqtrajtimi dhe neglizhence, dhe në mbështetje të fuqishme të vlerave dhe vizionit tonë që "çdo fëmijë rritet në një familje, me dashuri, respekt dhe siguri" si dhe do të promovoj zhvillimit të tyre.

2.6 Unë nuk do të filloj apo përfshihem në asnjë marrëdhënie romantike apo seksuale me fëmijët apo të rinjtë. Unë jam i vetëdijshëm se kjo marrëdhënie do rezultojë me pasoja ligjore dhe ndikojë në reputacionin e organizatës. Besimi i gabuar për moshën e një fëmije nuk shërben si mbrojtje.

2.7 Unë nuk do të shkëmbej paratë, punësimin, mallrat apo shërbimet me marrëdhëniet seksuale, përfshi favorizimet seksuale apo format e tjera të sjelljeve poshtëruese, degraduese apo shfrytëzuese. Shkëmbimi përfshin çdo shkëmbim ndihme që është parashikuar për pjesëmarrësit e shërbimeve të SOS-it.

2.8 Unë nuk do të kryej marrëdhënie seksuale me anëtarët e komunitetit lokal që ndihmohen nga SOS-i, pasi këto marrëdhënie ka shumë mundësi të minojnë besueshmërinë dhe integritetin e punës së Fshatrave të Fëmijëve SOS.

2.9 Unë nuk do të punësoj fëmijët si 'ndihmës në punët e shtëpisë' (punëtorë shtëpiakë²) apo për cdo lloj pune e cila mund të jete e rrezikshme apo të ndehyje edukimin e fëmijes, apo të demtojë zhvillimin mendor, fizik, moral social dhe shpirtëror të fëmijes.

2.10 Unë do të siguroj që puna ime me fëmijët të jetë e dukshme për të tjerët dhe në përgjithësi nuk do të kaloj kohë më tepër seç duhet duke qëndruar vetëm për vetëm me fëmijët dhe larg të tjerëve. Vetëm kur është e pershtatshme si rezultat i rolit tim (sos nene), unë do të kaloj periudha me të gjata vetëm me fëmijen. Unë nuk do të mbaj fëmijë në shtëpinë time (gjatë natës apo për periudha të zgjatura) veçanërisht kur nuk ka të pranishëm ndonjë të rritur tjetër përgjegjës.

2.11 Unë do të raportoj të gjitha shqetësimet në lidhje me abuzimin aktual apo të mundshëm të fëmijëve, keqtrajtimin apo çdo shkelje tjetër të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve në përputhje me sistemin tonë të raportimit dhe reagimit. Unë do ta bëj këtë me besimin se do të mbrohem dhe mbështetem nga organizata.

2.12 Unë do t'i ruaj si konfidenciale³ të dhënat për fëmijët dhe të rinjtë në programet e Fshatrave të Fëmijëve SOS (p.sh informacion mbi të kaluarën e tyre familjare, gjendjen shëndetësore, etj.⁴). Ky parim konfidencialiteti vlen edhe ndaj pjesëmarrësve të mëparshëm në shërbimet e SOS-it, vëllezërve dhe motrave të tyre, edhe pas momentit kur bashkëpunonjësit kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Fshatrat e Fëmijëve SOS.

2.13 Unë do të tregoj për cdo akuze të bëra ndaj meje në lidhje me fëmijet, si në momentin e punësimit tim në SOS Fshatrat e Fëmijëve, ashtu edhe gjatë kohës që unë jam i punësuar në këto organizate.

3. SJELLJA PROFESIONALE NË LIDHJE ME ASPEKTE TË TJERA TË PUNËS

Përdorimi me përgjegjësi i pushtetit dhe pozitës

3.1 Unë do të përdor pozicionin tim në dobi të organizatës në rast se do të kem të bëj me zyrtarë të qeverisë, donatorë, sponsorë, furnitorë dhe partnerë të Fshatrave të Fëmijëve SOS. Unë do të shmang cdo konflikt interesi që mund të dalë nga interesi i mia personale dhe/apo detyrimet që mund të kem ndaj personave me të cilët Fshatrat e Fëmijëve SOS kanë lidhje pune.

3.2 Unë jam i vetëdijshëm se fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit më respektojnë e admirojnë si një person me autoritet. Unë nuk duhet t'a përdorë këtë pozicion për përfitimin tim personal ose për përfitimin e familjes apo miqve të mij.

3.3 Kjo do të thotë se unë nuk duhet të hyj në asnjë lloj marrëdhënie biznesi në emër të Fshatrave të Fëmijëve SOS me familjen, miqtë apo kontaktet e tjera të mia personale/profesionale për të siguruar furnizim me mallra apo shërbim për Fshatrat e Fëmijëve SOS⁵.

3.4 Unë jam i ndergjegjshëm se punësimi i anëtarëve të familjes ose miqve të bashkëpunonjësve është totalisht i painkurajueshëm⁶. Unë e kuptoj se unë nuk duhet të kërkoj ose t'i jap shkas asnjë pagese personale, shpërblese apo favorit nga të tjerët, veçanërisht nga pjesëmarrësit në shërbimet e SOS-it, në shkëmbim të ndihmës, mbështetjes, mallrave ose shërbimeve tona të çdo lloji dhe se unë nuk do të pranoj rryshfete ose dhurata të rëndësishme (përveç dhuratave të vogla që bëhen në shenjë vlerësimi)⁷ nga

² Përcaktimi i punëve të shtëpisë, nuk përfshin angazhimin me raste si dado, ndihma në kopesht, apo ndihma gjatë ditëve të pushimit, apo jashtë orëve mesimore.

³ Konfidencial do të thotë "sigurimi që informacioni të jetë i aksesueshëm vetëm nga personat e autorizuar".

⁴ Fotografite dhe cdo informacion tjetër rreth pjesëmarrësve në programin SOS nuk duhet publikuar në media sociale (Facebook) pa pelqimin e tyre, apo të tutorit ligjor.

⁵ Përveç rasteve kur një blerje e tillë vjen si rezultat i një procesi prokurimi të hapur, të drejtë, transparent dhe të përgjegjshëm ku mallrat apo shërbimet e ofruara nga personi ose kompania përfaqësojnë cilësinë dhe vlerën më të mirë për Fshatrat e Fëmijëve SOS.

⁶ Manuali i Burimeve Njerezore, Standarti 5: Rekrutim Profesional

⁷ Ju duhet të njoftoni eprorin e linjës nëse ju janë ofruar apo keni marrë dhurata të çfarëdolloji.

qeveritë, pjesëmarrësit në shërbimet e SOS-it, donatorët, furnitorët ose të tjerë që ofrohen si rezultat i pozicionit tim.

3.5 Në rast të përfshirjes në aktivitete lokale politike, fetare, ose të komunitetit, unë angazhohen të siguroj se misioni i Fshatrave të Fëmijëve SOS dhe objektivat nuk do të komprometohen dhe Fshatrat e Fëmijëve SOS nuk do të diskretitohen.

3.6 Unë nuk do të konsumoj alkol dhe/ose nuk do të përdor asnjë substancë tjetër që ul në mënyrë të ndjeshme aftësinë time për punë ose dëmton reputacionin e organizatës.

3.7 Unë do të siguroj marrëdhënie pune të mira dhe konstruktive duke mos hyrë në marrëdhënie intime personale me bashkëpunonjës të tjerë. Unë jam i vetëdijshëm se marrëdhënie të tilla mund të ndikojnë në atmosferën e punës dhe moralin e bashkëpunonjësve. Nese une jam ne nje marrdhenie intime me menaxherin tim, apo ndonje punonjes qe raporton tek une, une do ta deklaroj kete marrdhenie.

Përdorimi i përgjegjshëm i burimeve

3.8 Unë do të administroj burimet⁸ që më janë besuar nga Fshatrat e Fëmijëve SOS në mënyrë transparente dhe të kujdesshme dhe në përputhje me kontrollet e vendosura që sigurojnë përdorimin optimal të materialeve dhe burimeve tona njerëzore.

3.9 Bashkëpunonjësit janë resursi më i rëndësishëm i Fshatrave të Fëmijëve SOS. Unë nuk do të sillem në mënyrë të tillë që të krijoj rrezik të panevojshëm për shëndetin tim dhe sigurinë e të tjerëve me të cilët unë punoj.

3.10 Unë do të përdor të gjithë kompjuterat dhe teknologjinë tjetër të informacionit në mënyrë të përgjegjshme dhe do ta përmbaj veten ndaj përdorimit të padobishëm, veçanërisht atij që ka lidhje me krijimin, shikimin, shkarkimin apo shpërndarjen e çdo materiali të papërshtatshëm apo fyes, përfshi, por jo vetëm, imazhet abuzuese të fëmijëve (pornografinë e fëmijëve).

3.11 Unë do të kryej punën time në mënyrë të përgjegjshme ndaj mjedisit në mënyrë që të shërbej si një shembull i mirë për fëmijët dhe të rinjtë në këtë drejtim dhe për t'u kaluar brezave të ardhshëm një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

Përdorimi me përgjegjësi i informacionit

3.12 Duke pasur parasysh se pozicioni im në Fshatrat e Fëmijëve SOS kërkon besim dhe konfidencë, unë do të veproj më maturi lidhur me përhapjen e informacionit jashtë kërkesave normale të punës sime. Unë nuk do të komunikoj asnjë informacion sensitiv apo potencialisht të dëmshëm tek organet apo individët jashtë SOS-it, përfshi përfaqësuesit e medias, pa autorizimin e duhur apo jashtë kufizimeve të përcaktuara në udhëzuesin përkatës të Fshatrave të Fëmijëve SOS. Ky kufizim shtrihet edhe përtej momentit kur bashkëpunonjësit kanë ndërprerë marrëdhëniet e punësimit me Fshatrat e Fëmijëve SOS.

3.13 Kur të shkëmbej informacion të përgjithshëm mbi fëmijët dhe bashkëpunonjësit (p.sh. të dhëna, foto, histori, etj. për qëllime të marrëdhënive me publikun), unë do të tregoj respekt dhe konsideratë të plotë për privatësinë dhe dinjitetin e tyre.

3.14 Unë zotohem të shkëmbej informacionin e kërkuar në kohë në mënyrë që të kontribuoj në një krijimin e një klime harmonike organizative, duke patur gjithmonë parasysh interesin më të mirë të fëmijës.

4. PASOJAT E SHKELJES SË KODIT TË SJELLJES

4.1 Çdo veprim i imi ka rëndësi! Unë e kuptoj se çdo shkelje e këtij Kodi të Sjelljes mund të sjellë pasoja serioze si për jetën e fëmijëve dhe të rinjve ashtu dhe për organizatën. Prandaj, Fshatrat e Fëmijëve SOS do të reagojnë ndaj shkeljeve të Kodit të Sjelljes si ta gjykojnë të përshtatshme, pa marrë parasysh pozicionin, statusin apo marrëdhëniet personale të bashkëpunonjësit që ka kryer shkeljen - në përputhje me legjislacion kombëtar dhe lokal dhe/ose politikat ekzistuese të SOS-it. Pasojat mund të përfshijnë masa disiplinore,

⁸ Si ato financiare ashtu edhe ato jo financiare

deri/dhe përfshi pushimin nga puna, dhe mundësinë e referimit të rastit tek autoritetet kombëtare, si p.sh. tek policia apo agjencive të tjera përkatëse.

4.2 Nëse do të jem në dijeni të ndonjë shkelje të Kodit të Sjelljes, unë e kuptoj se kam përgjegjësinë ta raportoj tek eprori im apo tek një person tjetër, pozicioni i të cilit e lejon të marrë raporte të tilla, për shembull një Person i Besuar për një incident apo shqetësim lidhur me mbrojtjen e fëmijëve.

4.3 Unë e kuptoj se në rast raportimi të një shkelje aktuale ose potenciale të Kodit të Sjelljes unë do ta bëj këtë në mirëbesim dhe se Fshatrat e Fëmijëve SOS do të më sigurojnë që unë nuk do të vuaj asnjë pasojë ose efekt negativ si rezultat i kryerjes së detyrës kundrejt raportimit, edhe në qoftë se pretendimi im provohet më vonë të jetë i rremë. Megjithatë, nëse unë me vetëdije ngre një pretendimi të rremë ose dashakeq atëherë unë gjithashtu e kuptoj se mund të bëhem objekt i masave disiplinore. Përveç kësaj, nëse del që unë kisha dijeni për sjelljen e pahijshme por nuk e raportova atë, unë jam i vetëdijshëm se mund të bëhem gjithashtu objekt i masave disiplinore.

4.4 Unë e kuptoj se Kodi i Sjelljes nuk mund të mbulojë të gjitha aspektet e një sjellje të mirë. Nëse do të kem ndonjë shqetësim lidhur me një sjellje potenciale të pahijshme apo thjesht sjellje që mund të sjellë diskreditimin e organizatës, marr përsipër të raportoj shqetësimet tek eprori im.

4.5 Në rastet kur objekt i shqetësimit është eprori i afërt, raportimet duhen bërë tek eprorët të tij ose të saj dhe tek Departamenti i Burimeve Njerezore.

5. NËNSHKRIMI DHE ZOTIMI

5.1 Unë e kam lexuar me kujdes dhe kuptuar në mënyrë të qartë Kodin e Sjelljes së Fshatrave të Fëmijëve SOS. Unë jam i vetëdijshëm se Fshati i Fëmijëve SOS pret nga unë që t'i përmbahen në çdo kohë standardeve të sjelljes të përshkruara në këtë Kod të Sjelljes. Unë e vlerësoj çdo aspekt të kuadrit dhe përmbajtjes së tij. Me nënshkrimin e këtij Kodi të Sjelljes, unë zotohem në unison me të gjithë organizatën e Fshatrave të Fëmijëve SOS të aspiroj dhe mbaj lart standartet e sjelljes dhe mënyrës së jetesës si një parakusht i shërbimit tim ndaj Fshatrave të Fëmijëve SOS.

5.2 Unë e nënshkruaj dhe marr një kopje të këtij dokumenti. Një kopje tjetër e dokumentit të nënshkruar do të vendoset në dosjen time të personelit.

Emri:

Data:

Nënshkrimi:

Vendi: Zyra Nacionale